



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
*Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborna komisija za žalbe i molbe*

**A nr. 148/2010**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Imer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e aktivistit z.Kujtim Bajrami nga subjektit politik, Partia Demokratike Kosovës (PDK) dega në Gjilan, paraqitur kundër subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave ne vende publike më sloganin “mos e le pa dal 77” që është e ndaluar më nenin 33 pika b, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) në Republikën e Kosovës si dhe me nenin 4 pika b, te Rregullës Zgjedhore nr.11/2009, në seancën e panelit të mbajtur me 19.04.2010, mori këtë:

### **V E N D I M**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

### **A R S Y E T I M I**

Z. Kujtim Bajrami, në cilësinë e aktivistit të PDK-s dega ne Gjilan ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se subjekti politik LDK ka vendosur postera ne administratën e përgjithshme publike më sloganin “mos e le pa dal 77” në Rrugën “Bulevardi i Pavarësisë” në Gjilan, që është e ndaluar më nenin 33 pika b, të LZP në Republikën e Kosovës si dhe me nenin 4 pika b, te Rregullës Zgjedhore nr.11/2009.

### **F A K T E T**

Më 29 Mars 2010, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga z.Kujtim Bajrami, në cilësinë e aktivistit të PDK-s dega ne Gjilan, i cili ka parashtruar ankesë me pretendim se subjekti politik LDK, ka vendosur postera ne administratën e përgjithshme publike më sloganin “mos e le pa dal 77” në Rrugën “Bulevardi i Pavarësisë” në Gjilan.

Parashtruesi i ankesës si provë ka sjell dy fotografi të bëra më datë 10.03.2010 në Rrugën “Bulevardi i Pavarësisë” në Gjilan.

## ANALIZË

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.5, parasheh si vijon:

*Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij. Në rastet kur ankuesi është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare ose çfarëdo personi tjetër juridik, ankesa duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar, në rastet kur kjo është e mundshme, në çfarëdo dispozite ligjore në fuqi.*

KZAP-i konstaton se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 3 pika 5 të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it, ngase në rastin konkret ankesa nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 148/2010 më datën 19.04.2010.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muharrem Shala**

